



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit

Nr. _____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ . 2021

Lenda: Dhënie informacioni.

Znj. _____

E nderuar,

Në përgjigje të kërkesës tuaj, datë 26.05.2021, marrë me datë 27.05.2021 nga Bashkia Shkodër me nr. prot 8153 Ju informojmë si më poshtë vijon:

1. Çfare po bëhet në kuadër të programit të 100 fshatrave turistik?
2. Kush janë zonat që janë investuar deri tani, dhe roli i Bashkisë në të gjithë këtë proces?

Programi i 100 fshatrave turistike është një program i iniciuar nga Qeveria Shqiptare në nëntor të vitit 2017 përmes thirrjes së bashkive për të aplikuar sipas kriterëve dhe metodologjise së percaktuar.

Qëllimet e Programit

Programi i Integruar për Zhvillimin Rural, synon të koordinojë ndërhyrjet zhvillimore në hapësirën rurale të 100 fshatrave, sipas qasjes ndërsektoriale dhe me shumë aktorë, duke u shkëputur nga ndërhyrjet e copëzuara dhe me qasje strikte sektoriale, që po ndodhin apo pritet të ndodhin në vend. Qasja e integruar për zhvillimin rural do të targetojë objektiva të matshme për zhvillimin e hapësirës rurale, nëpërmjet fokusit të qendëruar, që do të thotë programim i integruar dhe koordinuar i investimeve publike, atyre të donatorëve dhe investimeve private, në hapësirën e mirëpërcaktuar të 100 fshatrave, me potenciale të larta zhvillimi ekonomik-social, mjedisor dhe të trashëgimisë kulturore.

Impakti dhe Rezultatet

Nga kjo qasje zhvillimi, synohet që në përfundim të programit të kemi një transformim të ekonomisë rurale me rezultate të matshme dhe një impakt të lartë zhvillimor për 100 fshatrat e përzgjedhura si pjesë e programit. Konkretisht synohet:

- përmirësimi i parametrevë të zhvillimit ekonomik-social;
- rritja e numrit të bizneseve dhe punësimit;
- përmirësimi i mjedisit urban dhe natyror;

- përmirësimi i aksesit në infrastrukturë dhe shërbimet publike;
- përmirësimi i objekteve të trashëgimisë kulturore;
- rritja e numrit të vizitorëve vendas dhe të huaj;
- rritja e numrit të bizneseve start-up për gratë dhe të rinjtë;
- rivitalizimi i strukturave komunitare dhe shoqërisë civile;
- rritja e mundësive për trajnim dhe arsim profesional.

Çfarë përmban programi?

PIZHR do të programojë ndërhyrjet me investime të integruara në 100 fshatra, nëpërmjet 3 objektivave:

- 1) Përmirësimi i infrastrukturës publike (infrastrukturë rrugore, rivitalizime hapësirash publike/urbane, infrastrukturë komunitare, shërbime publike, infrastruktura mjedisore, turistike, qendra multifunksionale komunitare, pejsazhi mjedisor etj.);
- 2) Zhvillimi ekonomik nëpërmjet diversifikimit të aktiviteteve ekonomike (përmirësimi i potencialit turistik në hapësirat rurale, investimet në përmirësimin e shërbimeve tregtare, ekonomiko-financiare, turistike, agro-turizëm. Mbështetja për inkubatorë të produkteve rurale tradicionale, promovim dhe marketim të zonave rurale, shërbime transporti, panaire dhe festat lokale etj.);
- 3) Zhvillim i kapitalit social dhe njerëzor (mbështetja për krijimin e rrjeteve rurale dhe shoqërinë civile në zonat rurale, trajnim profesional për të rinjtë dhe gratë, mbështetje të trashëgimisë kulturore, mbështetje për promovimin e traditave dhe jetesës në fshat, etj.)
Kohëzgjatja e programit
- 4) “Programi i Integruar për Zhvillimin Rural –Programi i 100 fshatrave”, do të zbatohet në periudhën 2018-2020.

Zbatimi

Projektet e financuara në kuadrin e programit të 100 fshatrave do të zbatohen kryesisht nga bashkitë si dhe agjenci të tjera publike (Agjencitë e Zhvillimit Rajonal 1,2,3 dhe 4, Agjencia për Zhvillimin Ekonomik Rajonal, Agjencia Kombëtare e Turizmit, FSHZH, MADA, etj.).

Programi do të mbështesë edhe projekte të propozuara nga organizatat e shoqërisë civile (OJF), individë, fermërë, persona juridik etj., në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Financimi i programit

Programi i 100 fshatrave mund të financohet nga buxhetet e ministrive pjesëmarrëse në program. Në detajimin e fondeve për investime, të alokuara në buxhetet respektive të ministrive apo institucioneve të tyre të varësisë, ministrinë pjesëmarrëse në program do synojnë ti japin përparësi projekteve të identifikuara dhe që zbatohen në zonën e përcaktuar të 100 fshatrave.

Projektet e identifikuara në kuadrin e programit të 100 fshatrave, mund të **financohen** edhe nga **Fondi i Zhvillimit të Rajoneve**, sipas kriterëve dhe rregullave të përcaktuara nga Komiteti i Zhvillimit të Rajoneve.

Ministritë pjesëmarrëse, mund të nënshkruajë marrëveshje bashkëpunimi për grante, për financimin e këtij programi nga donatorë dhe me financim të huaj.

Programi mund të financohet nga çdo burim tjetër i ligjshëm apo nëpërmjet mekanizmave të partneritetit publik-privat.

Autoriteti Administrues

Për administrimin e Programit të Integruar për Zhvillimin Rural (PIZHR)-Programi i 100 fshatrave krijohet “Komisioni Ndërmintor për Programin e 100 fshatrave” me përbërje të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe Ministrit të Kulturës.

Komisioni Ndërmintor për Programin e 100 fshatrave

Komisioni ndërmintor mblidhet rregullisht për të vendosur mbi ecurinë e programit, por jo më pak se 1 herë në tre muaj. Komisioni, si autoriteti më i lartë vendimmarrës i programit, vendos për të gjitha çështjet që lidhen me administrimin, programimin, financimin, zbatimin dhe monitorimin e programit. Komisioni në veçanti vendos për:

- Shqyrtimin dhe miratimin e planeve të zhvillimit të fshatrave dhe projekt-ideve, që i paraqiten komisionit për mbështetje nga “Programi i 100 fshatrave”;
- Propozimin për masën e financimeve vjetore për programin e 100 fshatrave, nga buxhetet e ministrive pjesëmarrëse në program, dhe/ose ministrive të tjera si dhe nga FZHR-ja;
- Marrëveshjet e bashkëpunimit me donatorë dhe partnerë të tjerë, për mbështetjen e programit të 100 fshatrave;
- Miratimin e raport-progresit të zbatimit të programit;
- Çdo çështje tjetër që lidhet me administrimin e programit;

Për një koordinim dhe bashkërendim më të mirë të programit, komisioni zhvillon takime konsultuese me bashkitë dhe komunitetin e donatorëve.

Për zbatimin e këtij programi, Komisioni bashkëpunon në veçanti me bashkitë dhe Agjencitë Rajonale të Zhvillimit, si dhe me partnerë të tjerë publik apo privatë, që janë të interesuar për të mbështetur programin e 100 fshatrave.

Bashkia Shkodër pas konsultimeve me grupet e interesit, specialistë të fushave të zhvillimit urban e social ekonomik përcaktoi që të aplikohet në këtë program kaq ambicioz me tre fshatra të Bashkisë, që përbëjnë potencial zhvillimor më të lart: Drisht , Theth , Zogaj. Duke marrë parasysh nevojat për ndërhyrje në infrastrukturë, shërbime por edhe përmirësim të aseteve monumentale - kulturore, që përbejne elementet karakteristike të këtyre fshatave, Bashkia Shkodër ju përgjegj kësaj thirrjeje duke qënë po ashtu ambicioze me projekt propozimet për rikualifikimin total që këto zona kane nevojë.

Lista e fich projekteve te Fshatit **Drisht**, Nj. Administrative **Postribë**

Nr	Emertimi i fich projekteve	Vlera ne lekë
1	Rehabilitimi i segmentit të rrugës Ura e Mesit - Kalaja e Drishtit	205 000 000
2	Rikualifikimi i kalasë së Drishtit, përmes ndërhyrjeve të vogla në muret rrethuese të kalasë dhe rehabilitimit të fasadave të shtëpive të banimit në kala	15 000 000
3	Restaurimi dhe rikualifikimi urban i territorit në qendrën e fshatit dhe kalanë e Drishtit	38 000 000
4	Vënia në funksion e muzeut në kalanë e Drishtit.	6 000 000
5	Rikualifikimi i shkollës 9 vjeçare Drisht	6 500 000
6	Rehabilitimi i qendrës shëndetësore Drisht	2 500 000
7	Ndërtimi i Nyjes Bujqësore në Drisht	25 000 000
8	Tregu Rajonal BIO në Drisht	20 000 000
9	Promovimi i shërbimeve të turizmit rural në fshatin Drisht	5 000 000
10	Mbështetje të sipërmarrjeve “ start up” me fokus të rinjtë	500 000
	Totali	139 000 000

Lista e fich projekteve te Fshatit **Theth**, Nj. Administrative **Shalë**

Nr	Emertimi i fich projektit	Vlera ne lekë
1	Rikonstruksion i rruges Prekal- Nderlyse- Theth	1,304,198,000
2	Rikualifikimi urban i territorit të qendrës së fshatit Theth	123,272,688
3	Rehabilitim i urave ekzistuese në fshatin Theth.	14,382,890
4	Rehabilitimi i shkollës 9 vjecare Theth dhe krijimi i nje qendre multidisiplinare	6,200,000
5	Rehabilitimi i qendrës shëndetësore Theth	4,048,000
6	Ndertim i rrjetit te kanalizimeve te ujrave te zeza dhe ITUP ne luginen e Theth	418,500,000
7	Përmirësimi dhe rehabilitimi i rrjetit të furnizimit me ujë të pijshëm	6,000,000
8	Rehabilitimi i rrjetit të furnizimit me energji elektrike	277,155,000
9	Rehabilitimi i kullave tradicionale	21,600,000
10	Rehabilitimi i mullinjëve tradicionale	14,400,000

11	Fuqizimi i shërbimeve të zyrës së informacionit turistik	800,000
12	Ndërtimi i qendrës së grumbullimit dhe përpunimit të produkteve autoktone vendase	20,000,000
13	Përmirësimi i shërbimeve ndaj qytetarëve përmes ngritjes së zyrës me një ndalesë në Theth.	10,000,000
14	Përmirësimi i manaxhimit të mbetjeve urbane	7,000,000
15	Ndërtimi i dy stacioneve multimodale të transportit në Theth dhe në Ndërllysë.	16,000,000
16	Ndërtimi i fortifikimeve përgjatë bregut të lumit dhe pyllëzim me qëllim parandalimin e efekteve të erozionit	41,055,000
17	Përmirësimi dhe pajisja me sinjalistikën e posaçme të shtigjeve për këmbësorë	5,000,000
18	Promovimi i shërbimeve të turizmit rural në fshatin Theth	4,000,000
19	Restaurimi i banesës së Lulash Kecit (Muzeu etnografik i Dukagjinit) dhe vënia në funksion i këtij muzeu për vizitorët.	7,000,000
20	Krijimi i qendrës së artizanatit në Theth	5,000,000
	Totali	2,305,611,578

Lista e fich projekteve të Fshatit **Zogaj**, Bashkia Shkoder

Nr	Emertimi i fich projekteve	Vlera në lekë
1	Rehabilitim i aksit rrugor Shirokë - Zogaj - kufi	550,000,000
2	Rehabilitim i shesheve urbane të fshatit Zogaj dhe sistemimi i rrugëve dhe shkallareve karakteristike të fshatit, gjelbërim i peizazhit urban të zonës dhe ruajtjen e arkitekturës tradicionale.	21,700,000
3	Rikualifikim i plazheve dhe infrastruktures për zhvillimin e sporteve ujore	25,000,000
4	Rikualifikim i ballinave ujore Shirokë - Zogaj	10,000,000
5	Rehabilitim i dhe ripyllezimi i sipërfqeve të degraduara dhe të djegura të fshatit Zogaj.	22,500,000
6	Rehabilitim i Shkolles Zogaj	10,000,000
7	Rehabilitimi i qendrës shëndetësore Zogaj	5,600,000
8	Rritje dhe fuqizim i sektorit të peshkimit në fshatin Zogaj	31,620,000
9	Ngritja e një qendre për punimet artizanale të zonës	10,000,000
10	Krijimi i incentivave për diversifikimin e aktiviteteve ekonomike të zonës, si peshkimi, bimët medicinale, blektorja, punimet artizanale dhe sektori i turizmit	10,000,000
11	Trajnime me të rinjtë dhe gratë sipërmarrëse që operojnë në fushën e biznesit.	1,000,000
	Totali	698,120,000

Sipas Vendimit nr. 21, datë 12.1.2018 “Për disa shtesa në vendimin nr. 709, datë 29.10.2014, të këshillit të ministrave, “për miratimin e strategjisë ndërsektoriale për zhvillimin rural dhe bujqësor 2014 – 2020”

Bashkia Shkoder u shpall fituese për përfshirjen në këtë program të tre fshatrave përkatësisht: Theth, Drisht dhe Zogaj. Megjithëse këto fshatra u futën në programin e 100 fshatrave ecuria e investimeve të realizuara nga Qeveria në kuadër të këtij programi ka qënë shumë e ulët për të mos thënë inekzistente. Afati për realizimin ose minimalisht fillimin e projektimit të këtyre ndërhyrjeve ka qënë 2018 – 2021, ndërkohë në territor përveç investimit të Fondit Shqiptarë të Zhvillimit në rrugën Drisht – Kala e Drishtit, nuk ka pasur ndërhyrje të tjera të cilat do të plotësonin kërkesat e paraqitura nga Bashkia Shkodër për rikualifikimin dhe zhvillimin e 3 fshatrave në kuadër të këtij programi i cili po përmbillet dhe për Bashkinë Shkodër mbeti vetëm në stadin e deklarimeve.

Me respekt,

KRYETAR

VOLTANA ADEMI